



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:232442

Datë: 27.06.2024

Numri i dokumentit: 05867471

KF.nr.470/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, të paditësit “PRIME” Sh.P.K., me seli në Gjilan dhe numër unik identifikues 811187683, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Kushtrim Bytyqi, Avokat nga Prishtina, kundër të paditurit Dogana e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike - anulim vendimi, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor publik të mbajtur, në prani të përfaqësuesit të autorizuar të palës paditëse Kushtrim Bytyqi Avokat dhe në prani të përfaqësueses të autorizuar të palës së paditur Blerta Gagica, me datë 19.06.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET kërkesëpadia e paditësit “PRIME” Sh.P.K., me seli në Gjilan, si e bazuar.
- II. ANULOHET aktvendimi nr.01.3.2.2/14309,15422 i datës 26.08.2021 i Doganës së Kosovës dhe lënda KTHEHET NË RISHQYRTIM DHE RIVENDOSJE.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi “PRIME” Sh.P.K., me seli në Gjilan, me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 18.10.2021, ka iniciuar kontestin tregtar administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me të cilën i ka propozuar gjykatës të aprovohet kërkesëpadia si e bazuar, të anulohet aktvendimi nr.01.3.2.2/14309,15422 i datës 26.08.2021 dhe të detyrohet e paditura Dogana e Kosovës që ti kthej paditësit mjetet e paguar në emër të detyrimeve të importit të paguara mbi vlerën e transaksionit, me kamatë prej 8 % nga pagesa deri në kthimin e plotë. Në seancën e

shqyrtimit kryesor përfaqësuesi i palës paditësi ka deklaruar se mbesin në tërësi si në të theksuarat në padi duke konsideruar se e paditura me anë të aktvendimit të atakuar ka bërë shkelje ligjore të referuara në padi përkatësisht nenit 33 të KDA lidhur me neni 123 të UA 11/2009 pasi që paditësi DUD-ave kontestues i ka bashkangjitur dokumentet relevante për të vërtetuar çmimin e transaksionit përfshirë këtu edhe urdhërpagesat bankare në emër të faturave të mallit e të cilat janë të elaboruar më në detaje në pikën 2 të padisë ku janë të evidentuar edhe kontratat për shitblerjen e mallrave lëndore. Tutje ka theksuar se e paditura siç mund të shihet nga arsyetimi i aktvendimit të atakuar nuk ka shqyrtuar këto dokumentet por është fokusuar vetëm në mungesën e deklaratave eksportuese por konsiderojnë se ky qëndrim juridik nuk ka mbështetje ligjore sepse ky dokument nuk përcaktohet obligativ në dispozitat ligjore të theksuara më sipër. Ka cekur se arsyetimi i aktvendimit të atakuar nuk vërteton në mënyrë të plotë gjendjen faktike të dokumenteve dhe të vlerës së mallit andaj konsiderojnë se nuk është e mundur që kjo lëndë të zgjidhet në mënyrë meritore në gjykatë. Me propozim për gjykatën të aprovojë kërkesëpadinë e paditësit në tërësi si të bazuar ashtu që të anulohet aktvendimi i atakuar dhe lëndën të kthejë në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura me rekomandimin që të rishqyrtohen dokumentet e paditësit që i ka bashkangjitur DUD-ave kontestues me qëllim të vërtetimit të çmimit të transaksionit.

E paditura, në përgjigje në padinë të datës 14.06.2022 e konteston në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit. Aktvendimi i atakuar është marrë konform të gjitha dispozitave në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marrë me shkelje ligjore nuk qëndron fare, me arsyetimin se vendimi i kontestuar është marrë konform legjisllacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar as edhe me një provë të vetme. Përfaqësuesja e palës së paditur në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar se e kontestojnë në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar, mbesim në tërësi pranë përgjigjes në padi si dhe pranë sqarimeve edhe elaborimeve si në arsyetimin e nxjerrë të aktvendimit nga Dogana duke theksuar se në procedurën e administrimit të provave i njëjti nuk ka prezantuar deklaratën eksportuese gjithashtu edhe kontrata e prezantuar nuk është në gjuhë zyrtare dhe si të tillë kërkojmë nga gjykata që mos t'ia fal besimin kësaj prove. Gjykatës i propozon që të marrë aktgjykim me të cilin refuzohet në tërësi si e pabazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit dhe ta lë në fuqi vendimin kontestues si të drejtë dhe të ligjshëm.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik të datës 19.06.2024, ka administruar provat si në vijim: DUD-at kontestues, faturat dhe profaturat përcjellëse, Aktvendim 01.3.2.2/14309/15422, Ankesë e datës 28.07.2021, Pagesat bankare e datës 15.07.2021, 09.07.2021 (2 pagesa), 16.07.2021, 19.07.2021, 22.07.2021, 23.07.2021, 27.07.2021, 06.08.2021 (2 pagesa), Kontratat e shitblerjes, CMR.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në padi dhe seancë, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave se bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë kontest tregtar administrativ, nga DUD-at kontestues të Doganës së Kosovës, deklarimeve në padi, shkresat e lëndës, aktvendimi kontestues, dhe deklarimeve në seancën e shqyrtimit kryesor, Gjykata ka gjetur se paditësi ka paraqitur DUD-at R17975/30.06.2021, R18169/01.07.2021, R18421/03.07.2021, R18692/06.07.2021, R19215/10.07.2021, R19508/13.07.2021, R19508/13.07.2021, R20270/19.07.2021, R20460/21.07.2021, R20583/22.07.2021, R20706/23.07.2021, R20811/24.07.2021, R20884/26.07.2021, R2153/28.07.2021, R21167/28.07.2021, R21457/30.07.2021, R17811/31.07.2021, R21601/31.07.2021, R21700/02.08.2021, R21991/04.08.2021, R21940/04.08.2021, R22225/06.08.2021, R22335/07.08.2021, R20459/21.07.2021, R20705/23.07.2021, R21371/29.07.2021, R21602/31.07.2021, dhe R21701/02.08.2021 të proceduara në ZBD Ferizaj. Për shkak se e njëjta i ka rivlerësuar mallin e deklaruar, paditësi ka ushtruar ankesë në Doganën së Kosovës, e për të cilën ankesë, Dogana e Kosovës me datë 26.08.2021 ka marr Aktvendimin nr. 01.3.2.2/14309, 15422, si akt administrativ përfundimtar i nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë, me të cilin është refuzuar kërkesa e subjektit në procedurë për rishqyrtimin e DUD-ave kontestues, kundër të cilit, paditësi me padinë e datës 18.10.2021, ka iniciuar kontestin tregtar administrativ pranë kësaj gjykate.

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, Gjykata konstaton se e paditura Dogana e Kosovës në shkallë të dytë e ka refuzuar kërkesën e subjektit në procedurë këtu paditësit për rishqyrtimin DUD-ave të ZBD Ferizaj. E paditura ka vlerësuar se Sektori i Pranimit Qendror ka vepruar drejtë kur ka kontestuar vlerën e mallit lëndor pasi që vlera e deklaruar për zhdoganim nuk është vlera reale e paguar për mallin me qëllim të importit në vendin tonë, për arsye se është deklaruar vlerë më e vogël se sa vlera reale e paguar apo që ka për tu paguar për mallin e shitur për eksport përkatësisht import në vendin tonë, në vështrim të nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës. Tutje theksohet se Sektori i Pranimit Qendror ka vepruar drejtë kur gjatë vlerësimit të mallit janë bazuar në metodën e gjashtë të vlerësimit, neni 35, të Kodit Doganor dhe Akcizave të Kosovës, respektivisht në bazë të të dhënave të disponueshme të Doganës së Kosovës, derisa caktimi i vlerës së mallit bazuar në të dhënat e disponueshme paraqet një të dhënë të besueshme, gjithmonë duke pas parasysh që Sektori i Vlerës (Sektori i specializuar për vlerësimin e mallit) në vazhdimësi ka përcjell ndryshimet e çmimit për mallin lëndor kontestuese, andaj në bazë të këtyre ndryshimeve përkatësisht karakteristikave të ngjashme të mallit, kanë përcaktuar çmimin për mallin lëndor.

Më tej, si arsye dhe fakt vendimtar që kanë ndikuar në mos pranimin e vlerës së transaksionit për mallin lëndor të zhdoganuar sipas DUD-it kontestues, e paditura ka theksuar se dokumentacioni i mallit lëndor është konsideruar i pamjaftueshëm, për arsye se subjekti nuk ka prezantuar deklaratën eksportuese, ndërsa e paditura e ka rivlerësuar mallin duke u referuar të dhënave të disponueshme lidhur me vlerën e mallit.

Gjykata nga aktvendimi kontestues vëren se ai përmban të meta të cilat e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, të metat e tilla konsistojnë në faktin se arsyetimi i vendimit kontestuese përmban të dhëna të pamjaftueshme dhe jo të plota sa i përket rivlerësimit të mallit lëndor. Në arsyetimin kontestues nuk është dhënë arsyetim i bazuar, sa i përket rivlerësimit të mallit të importuar sipas deklaratave unike doganore, kur paditësi ka prezantuar dokumentacionin obligativ për të bërë bindës vlerën e transaksionit dhe vlerën reale të mallit, duke i prezantuar për DUD-at kontestues: profatura nr.935/2021, urdhërpagesa bankare të datës 15.07.2021, kontrata e shitblerjes datës 28.06.2021, fatura nr.T2102679, profatura nr.972/2021, konfirmimi i pagesës datës kontrata e shitblerjes e datës 06.07.2021, fatura T2102820, fatura nr.T2102820, profatura 972/2021, kontrata e shitblerjes e datë 06.07.2021, transferi bankat i datës

09.07.2021, fatura T2102899, profatura nr.1017/2021, kontrata e shitblerjes datës 15.07.2021, transferi bankar i datës 09.07.2021, fatura nr.T2102904, profatura nr.1034/2021, kontrata e shitblerjes e datës 19.07.2021, transferi bankarë i datës 19.07.2021, fatura nr.T2102954, profatura nr.1042/2021, kontrata e shitblerjes datës 19.07.2021, tansferi bankar i datës 22.07.2021, fatura nr.T2102973, profatura nr.1054/2021, kontrata e shitblerjes e datës 22.07.2021, transferi bankar i datës 23.07.2021, fatura ne. T2103022, profatura nr.1069/2021, kontrata e shitblerjes e datës 23.07.2021, transferi bankar i datës 27.07.2021, fatura nr.94-08311, transferi bankar i datës 06.08.2021, fatura nr.96-08569 dhe transferi i datës 06.08.2021, dhe nuk është dhënë asnjë provë për të dëshmuar konstatimin e dhënë të vlerës së mallit të deklaruar për zhdoganim nuk duhet t'i pranohet vlera e transaksionit.

Mos vërtetimi i plotë i gjendjes faktike, Gjykata e konsideron faktin se vendimi i kontestuar nuk përmban arsye për faktet vendimtare të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje juridike-administrative. Në arsyetim të vendimit kontestues, thuhet se Sektori i Pranimit Qendror ka vepruar drejt kur ka kontestuar vlerën e mallit lëndor, pasi që vlera e mallit e deklaruar për zhdoganim nuk është vlera reale e paguar për mallin me qëllim të importit në vendin tonë, për arsye se është deklaruar vlerë më e vogël se sa vlera reale e paguar apo që ka për tu paguar për mallin e shitur për eksport, përkatësisht për import në vendin tonë, në vështrim të nenit 33, të KDA-së, mirëpo një konstatim i tillë për Gjykatën është tërësisht i pa qëndrueshëm dhe i pa mbështetur në prova materiale, është shumë kontradiktor në vetvete dhe në raport me dokumentacionin e prezantuar, si dhe me bazën ligjore në fuqi, dhe sepse e paditura nuk ka qenë të gjendje të provojë këtë konstatim, kjo edhe përmes ndonjë dëshmie me të cilin do të argumentohet se paditësi, nuk e ka përcaktuar vlerën reale.

Gjykata ka shqyrtuar vendimin kontestuese dhe pretendimet e paditësit lidhur me prova përkatësisht profaturat, faturat konfirmimet e pagesave, kontratat e shitblerjes, transaksionet bankare, që me anë të këtyre provave të dëshmoj para Doganës që në kuptim të dokumenteve përcjellëse të prezantuara, janë të harmonizuar në tërësi në kuptim të vlerës dhe të përshkrimit me transaksion bankar. Gjykata vlerëson se legjislacioni doganor nuk përmban dispozita ku thuhet se vlera doganore e mallrave të importuara, duhet të jetë në përputhje me vlerën e të dhënave të disponueshme nga Dogana e Kosovës, apo se mungesa e deklaratës eksportuese është fakt

vendimtar për refuzimin e ankesës, të gjitha këto kur në rastet kur ka dokumentacion përcjellës të harmonizuar, por përkundrazi tek neni 33 par.1 të KDA-së është parashikuar se “*Vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaksionit, që paraqet çmimin vërtetë të paguar ose të pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, i përshtatur, sipas nevojës, në përputhje me nenet 36 dhe 37*”.

Gjykata e obligon të paditurën se në rishqyrtim dhe rivendosje, duhet te konstatoj këto pretendime të cekura si më lartë dhe argumentet e paditësit dhe të deklarohet lidhur me provat e administruara profaturat, faturat, konfirmimet e pagesave, kontratat e shitblerjes, transaksionet bankare të cilat janë të harmonizuara në tërësi në kuptim të vlerës. Në arsyetimin e vendimit kontestues shihet se e paditura nuk ka shqyrtuar drejtë pretendimet e paditësit për të konstatuar se fatura dhe dokumentet tjera përcjellëse përse janë kontestuar, pra nuk janë marr për bazë dhe nuk i ka pranuar si valide, andaj një akt administrativ i tillë nuk përmban një përmbledhje të konstatimeve faktike bazuar në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ ose në faktet e siguruar nga administrata.

Të metat e mësipërme janë të asaj natyre që e bëjnë të pa mundur vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, prandaj aktvendimi i atakuar u deshtë që doemos të anulohet, tutje Gjykata e obligon të paditurën që në ri procedurë të deklarohet lidhur me provat e paraqitura nga paditësi përkatësisht profaturat, faturat konfirmimet e pagesave, kontratat e shitblerjes, transaksionet bankare të cilat janë të harmonizuara në tërësi në kuptim të vlerës, lidhur me DUD-at kontestues për zhdoganim pranë Zyrës së Brendshme Doganore Ferizaj, dhe të administruar nga Gjykata e të cilat u përmenden më lartë.

Me rastin e nxjerrjes së vendimit të ri, e paditura të vlerësoj drejt gjendjen faktike që rezulton nga dokumentacioni i mallit dhe të aplikoj drejt dispozitat ligjore me të cilën përcaktohet pagesa për mallin lëndor kontestues. Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, duke u bazuar në nenin 65, të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Gjykata vendos për çështjen e konfliktit administrativ në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative, në vështrim të nenit 43, paragrafi 1, të LKA-se. Në bazë të këtij parimi,

Gjykata e ka të pamundur të vendos në mënyrë meritore në këtë konflikt administrativ për arsye se ekzistojnë të meta të cilat e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, andaj e aprovon padinë e paditësit, anulon aktvendimin e kontestuar, dhe lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje. Gjykata bazuar në autorizimet nga neni 43 par.2 të LKA-së e detyron të paditurën, që në ri procedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në arsyetim të këtij aktgjykimi.

Vendimi që secila palë t'i bart shpenzimet e veta procedurale është marrë konform nenit 64, të LKA-së.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, Gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 43, par 2, e 46, par 1 dhe 2, të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal
KF.nr.470/22 datë 19.06.2024

Gjyqtarja
Vera Gashi Bala

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj gjykate.